lajmi.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet më të fundit nga Lajmi.net?
Jo, faleminderit
Pranoj

Plagosje në fshatin Kijevë të Malishevës, dy të arrestuar



24/09/2025 18:47

Një plagosje ka ndodhur sot në fshatin Kijevë të Malishevës.

Një i mitur është qëlluar me armë zjarri, nga një i mitur tjetër.

Rastin për lajmi.net, e ka konfirmuar zëdhënësi i policisë për rajonin e Gjakovës, Sheremet Elezaj.

Elezaj tha se ngjarja ka ndodhur pas një mosmarrëveshje me dy të mitur të tjerë, të cilët janë arrestuar në cilësinë e të dyshuarve.

"Rreth orës 15:45, në fshatin Kijevë të Malishevës, një i mitur është plagosur me armë zjarri pas një mosmarrëveshjeje me dy të mitur të tjerë. Viktima është dërguar për trajtim mjekësor, gjendja e tij shëndetësore është stabile dhe jashtë rrezikut për jetë. Policia ka arrestuar dy të dyshuarit dhe ka sekuestruar një armë zjarri, ndërsa me autorizim të prokurorit po ndërmerren veprimet e mëtejme hetimore", ka thënë Elezaj. /Lajmi.net/

LAJME TË FUNDIT

Salihu reagon pas incidentit në Komunën e Prishtinës:...

Kurti viziton për ngushëllime familjen e Enver Petrovcit:...


Kryediplomati italian kërkon "riunifikimin e Ballkanit Perëndimor me...

Revista ku ofendohej UÇK-ja, Basha: Është hequr emri...

Artikuj të ngjashëm

September 24, 2025
Salihu reagon pas incidentit në Komunën e Prishtinës: Nuk kam sulmuar...

September 24, 2025
Kurti viziton për ngushëllime familjen e Enver Petrovcit: I kishte të...

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy